



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 03 shkurt 2015, në orën 10:00,
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Fatmir Limaj, Duda Balje, Naim Fetahu dhe Adem Grabovci

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e komisionit dhe Mehmet Simnica zyrtar i fushës për ekonomi në komision.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Sanije Berisha OSCE, Shefki Kastrati NDI, Qendresa Mulaj ZAP, Fitore Berisha dhe Florina Merovci nga Zyra e Presidenti.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 27.01.2015;
3. Miratimi i Planit të punës së KMFP për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i kërkesës për përzgjedhjen e Auditorëve të jashtëm për Auditimin e Bankës Qendrore të Kosovës;
5. Përzgjedhja e Auditorit të jashtëm të pavarur për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
6. Të ndryshme;

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari- A jeni për këtë rend dite, a ka dikush diçka në lidhje me rendin e ditës. Të gjithë u pajtuan me rendin e ditës.

***Kryetari -** Konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa asnjë ndryshim.*

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 27.01.2015.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.01.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Planit të punës së KMFP për vitin 2015

Kryetari- nga mbledhja e kaluar e KMFP, në të cilën takim përveç tjerash është diskutuar edhe plani i punës. Sekretaria e KMFP ka përgatitur një plan të punës për të cilën i falënderojë. Tani nga NE kërkohet aprovimi i këtij plani të punës i cili mund të ndryshohet gjatë vitit varësisht nga interesimi i Komisionit. Ne kemi patur edhe disa interesime të shoqërisë civile për të interferu në planin e punës së KMFP, propozime të cilat janë përkrahë nga NE. Me këtë hapi diskutimin.

Ali Sadriu– Unë mendoj që përveç asaj që është paraparë në planin e punës nga drafti fillestar, është mirë që të vizitojmë gjatë muajit Maj dhe Nëntor të vitit 2015 edhe Agjensionin Kosovar të Privatizimit si dhe Televizionin e Kosovës. Kjo për një arsye se raportet e punës së këtyre institucioneve nuk janë aprovuar në Kuvend vitin e kaluar për shkak të defekteve që kanë patur në menaxhim si dhe të gjeturave nga raportet e auditimit.

Hajdar Beqa- edhe unë pajtohem që në muajin Maj të vizitojmë këto institucione dhe të njoftohemi me për se afërmi me punën e tyre, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohen këto institucione.

Bali Muharremaj- Unë mendojë se plani i punës së komisionit është aprovuar në parim në mbledhjen e javës së kaluar mirëpo, nëse është e arsyeshme ne mund të shtojmë edhe këtë objektiv të cilën e propozoj zv. Kryetari.

Kryetari- pra në planin e punës së komisionit të shtohet edhe kjo objektiv sipas propozimit të zv. Kryetarit Sadriu. E hodhi në votim propozimin dhe me pajtim me të gjithë deputetët e pranishëm votuan pro planit të punës së komisionit për vitin 2015.

Përfundim

Aprovohet plani i punës së KMFP për vitin 2015, me vërejtjet e propozuara nga Ali Sadriu.

4.Shqyrtimi i kërkesës për përzgjedhjen e Auditorëve të jashtëm për Auditimin e Bankës Qendrore të Kosovës;

Kryetari- Ne në materialin prezantues nga sekretaria e komisionit kemi, kërkesën e bankës qendrore, bashkë me raportin e vlerësimit të dosjes së tenderit për përzgjedhjen e kompanisë audituese për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e PVF të Bankës Qendrore për vitet 2014-2016. I ftuar për këtë qeshje është edhe zv. Guvernatori i BQK i cili e ka fjalën.

Fatmir Gashi, zv. guvernator i BQK-së- Komisioni vlerësues i përberë nga zyrtar të fushës së auditimit, bazuar në Ligjin mbi Bankën Qendrore dhe në standardet që i përcakton Ligji i Prokurimit Publik kanë përcaktuar kriteret dhe në bazë të këtyre kriterëve kanë hartuar raportin e komisionit vlerësues për këtë dosje të tenderit të njëjtën, ju kemi dorëzuar juve si komision funksional për të bërë një aprovim formal. Bazuar në kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit dhe bazuar nga raporti i komisionit vlerësues, ishin 4 kompani audituese që kishin plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara. Komisioni vlerësues pas analizimit të dosjes ka dalë me një propozim se kompania „Deloitte sh.p.k Kosova” është kompani e cila është me pike më së shumti prej 95.8 pikë, bazuar gjithëherë në dosjen e tenderit. Sipas Ligjit mbi bankën qendrore thuhet se para se të bëjë aprovimin e kërkesës së komitetit të auditimit Bordi i BQK-së duhet paraprakisht të ketë një aprovim nga KMFP. Unë personalisht kërkojë nga KMFP të aprovoi kërkesën tonë dhe të fillojnë procedurat për auditimin e BQK-së. Kjo është kërkesë edhe e FMN-së dhe Bankës Botërore.

Kryetari- pyeti? Gjatë analizimit të raportit të komisionit vlerësues vërehet se dikund thuhet „Deloitte Kosova” ndërsa në disa faqe tjera vetëm Deloitte. A bëhet fjalë për të njëjtën kompani? Po ashtu dëshirojë të dijë se a janë zbatu rregulla të njëjta edhe viteve të kaluara sa i përket përqindjes së aspektit teknik dhe atij financiar, në kriteret e dosjes së tenderit?

Fatmir Gashi- Po është e njëjta Kompani, mirëpo „Deloitte Kosova” është e licencuar për të bërë auditimin në Kosovë sipas legjislacionit të Kosovës. Po ashtu kriteret kanë qenë 50 me 50 në përqindje.

Ali Sadriu- KMFP edhe në takimin e javës së kaluar në propozimin e rendit të ditës, është hjek kjo pikë me të vetmin qëllim që të thirren zyrtaret e BQK-së për arsyetim të kërkesës, si dhe të kompletohet materiali. Nga materiali që kemi para vetes nuk mund të shihet sakët se a kanë ofruar kompanitë ofertuese materialet e nevojshme si dhe në rastin konkret NE mund të bazohemi vetëm në raportin e komisionit vlerësues. Raport ky i cili është hartuar nga vete të punësuarit e BQK-së, kuptohet me asistimin e një zyrtari nga Komiteti i Auditimit. Dy kompani audituese të cilat kanë pasur çmimet me të lira „BDO Kosova” dhe „Deloitte Kosova” me një diferencë prej 2,700 euro. Unë nuk mund të pajtohem pa pasur dosjen e tenderit komplet në shqyrtim.

Fatmir Gashi- sa i përket NE si menaxhment pak ka rëndësi cila kompani do të fitonte tenderin, qëllimi ynë është që të zgjedhim një kompani e cila do të auditojnë BQK dhe të kryejnë një obligim ligjor.

Synavere Rysha- në bazë të materialeve të ofruara, shihet çartë se cila kompani është fituese e kësaj dosje të tenderit. Mirëpo vërejtja ime është sa i përket përqindjes së ndarë 50% për specifikacionit teknik ndërsa, 50% për çmimin më të lirë. Mendoje se sipas materialit prezantues vërehet se kompania audituese „ Deloitte shpk Kosova” ka plotësuar kuotën e pikëve më të larta. Po ashtu pyeti se komisioni për shqyrtim të ankesave është në përbërje të të punësuarve nga BQK-ja?

Fatmir Gashi- Po është e vërtetë se në shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomik kanë marrë pjesë të punësuarit e Bankës Qendrore, mirëpo kjo është në harmoni të plotë me rregullat që i ka përcaktuar ligji mbi Bankën Qendrore.

Bali Muharremaj- theksoi se bazuar në materialet e dorëzuara nga BQK vërehet se sipas kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit, kushtet i kanë plotësuar 4 kompani mirëpo fituese është caktuar kompania „Deloitte Kosova” edhe pse shuma prej 47,000 eurove me duket pak sa e lartë për auditimin e BQK-së për tri vitet 2014-2016.

Hajdar Beqa- sa i përket çmimit të ofertueseve, kjo përcaktohet në baze të çmimit të tregut, edhe pse diferenca në mes kompanisë së pare dhe të dyte është për 2,700 euro. Po ashtu kam një pyetje sa i përket ankese së kompanisë së dytë që nuk ka fituar tenderin kjo ankese a është shqyrtuar nga OSHP-ja.

Fatmir Gashi- jo nuk ka patur shqyrtim nga OSHP-ja, ngase sipas Ligjit mbi Bankën Qendrore, Ligji i Prokurimit Publik dhe Ligji i Shërbimit Civil nuk janë të zbatueshëm për Bankën Qendrore. BQK është Organ i Pavarur.

Ali Sadriu- Unë mendoje se përgjegjësia e KMFP është me e larte se sa po thuhet këtu. Është e vërtetë se Ligji i BQK-së i jep të drejt kësaj të fundit për zgjedhjen e kompanisë audituese për Auditimin e Bankës Qendrore. Unë mendoje se kjo qeshje duhet të diskutohet në instanca më të larta.

Kryetari- e hodhi në votim kërkesën e Bankës Qendrore dhe me shumicë votash, KMFP e aprovojë kërkesën e BQK për përzgjedhjen e kompanisë audituese për auditimin e Bankës Qendrore për vitet 2014-2016 sipas raportit të komisionit vlersues.

Përfundim

Aprovohet kërkesa e Bankës Qendrore për përzgjedhjen e kompanisë audituese për auditimin e Bankës Qendrore për vitet 2014-2016. Sipas specifikacionit teknik të dosjes së tenderit, kompania audituese „ SHPK. Deloitte Kosova” shpallet fitues me çmimin prej 47,676 euro.

5.Përzgjedhja e Auditorit të jashtëm të pavarur për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Kryetari- theksoi se Ligji mbi Auditorin e Jashtëm në nenin 6 pika 6.1, i jep të drejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës të zgjedhë një kompani audituese për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it. Sipas kësaj kërkohet nga KMFP të nxjerre një rekomandim për këtë.

Përfundim

Të autorizohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria për prokurim, të bëjë përzgjedhjen e kompanisë audituese, për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të përgjithshëm për vitin 2014. Lidhur me përzgjedhjen e Kompanisë Audituese, Drejtoria e Prokurimit duhet të njoftoj me raport, Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, pas përfundimit të procesit të auditimit të ZAP-it, njofton Kryesinë e Kuvendit.

Kryetari i komisionit, me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi